



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS TË AVOKATIT TË POPULLIT

lidhur me vizitën në

Qendrën për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime

**Për: Z. Uran Ismaili, Ministër
Ministria e Shëndetësisë**

**Z. Basri Sejdiu, Drejtor
Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës**

**Z. Miftar Zeneli, Drejtor
Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e
të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime**

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ka vizituar Qendrën për Integrim dhe Rehabilitim të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (QIRSKP).

Prishtinë, 26 tetor 2018

Datat e vizitës dhe përbërja e grupit monitorues

1. Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 16 maj 2018, ka vizituar Qendrën për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (në tekstin e mëtejshëm “QIRSKP”). Grupi monitorues përbëhej nga Zëvendësja e Avokatit të Popullit, një jurist, një mjeke, një psikologe dhe dy ekspertë të Këshillit të Evropës (në cilësi të vëzhguesit).

Bashkëpunimi i institucionit me MKPT gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës së MKPT, personeli i QIRSKP-së i ofroi bashkëpunim të plotë ekipit monitorues. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat dhe iu mundësuan bisedat me disa nga rezidentët të cilët ishin koshient dhe ishin në gjendje të komunikonin, si dhe biseda u realizua pa prezencën e personelit të Qendrës.

Përshkrimi i shkurtë i institucionit

3. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (QIRSKP), funksionon në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) dhe ofron shërbime 24 orë në ditë. QIRSKP është institucion i tipit të hapur, rezidentët në këtë Qendër janë kryesisht të diagnostikuar me çrregullime psikotike, si *Schizophreniae*. Gjatë vizitës së MKPT në këtë institucion ndodheshin 61 rezidentë, prej tyre 32 të gjinisë mashkullore, 29 të gjinisë femërore, mosha mesatare sillej rreth 54 vjeç. Kapaciteti zyrtarë i institucionit është për 65 persona. Ky institucion përbëhet nga 4 reparte (A1- A4). MKPT, gjatë vizitës, ka vërejtur se është duke u rinovuar dhe ndryshuar struktura e reparteve A1 dhe A2 duke synuar mjedise sa më familjare.

Legjislacioni relevant

4. Ligji Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2015 dhe ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore. Sipas neni 12 të Ligjit për Shëndetin Mendor, QIRSKP është njësi organizative e SHSKUK dhe ofron shërbime të nivelit sekondar.
5. Përmes raportit me rekomandime për vizitën në QIRSKP, i cili është publikuar më 6 mars 2017, MKPT e Avokatit të Popullit, u rekomandoi autoriteteve kompetente të nxjerrin aktet nënligjore ashtu siç parashihet me Ligjin nr. 05/L-025 për Shëndet Mendor.
6. Më 20 mars 2017, Zyra Ligjore e Ministrisë së Shëndetësisë, e njoftoi MKPT të Avokatit të Popullit se *“në fund të vitit, Ministria e Shëndetësisë do të hartojë planin legjislativ për aktet nënligjore për vitin 2018, duke marrë parasysh edhe rekomandimin e Avokatit të Popullit për nxjerrjen e aktit nënligjor në pajtim me nenin 18, paragrafi 2 i Ligjit nr05/L-025 për Shëndet Mendor”*.

Kushtet e banimit

7. Dhomat ku banojnë rezidentët janë me nga dy shtretër. Në një repart tjetër ishte një dhomë me 4 dhe një me 5 shtretër. Dhomat janë dobët të lyera, nuk kanë komodina personale me qelës, nuk i mbyllin dyert e dhomave, nuk ka grila metalike në dritare, janë të hequra bravat në dritare. Disa piktura në mure janë vetëm në dhomën e qëndrimit ditor. Banjat janë pa perde, disa rrjedhin tërë kohën. Pacientët janë të veshur me rroba personale, ndonëse u janë dhënë pizhamet. Çdo ditë ndërrohen çarçafët, ndonjëherë edhe dy herë në ditë. Ujë të ngrohtë ka vazhdimisht.

8. Sipas standardeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe dekorimit të dhomave të pacientëve dhe mjediseve të argëtimit, për tu dhënë pacientëve stimulim pamorë, gjithashtu vënia në dispozicion e komodinave pranë krevatit dhe gardërobave është shumë e dëshirueshme. Gjatë vizitës së MKPT-së, në dhomat e rezidentëve kishte komoda për vendosjen e rrobave dhe gjërave personale, mirëpo rezidentët nuk kishin veshmbathje personale, pas çdo pastrimi ato ndërrohen mes rezidentëve, gjithashtu nuk kishte as dekorime për stimulim pamorë.
9. **MKPT vlerëson se kushtet e banimit në QIRSKP janë mesatare.** Megjithatë, janë të nevojshme renovime si lysterje, rregullim i elementeve të tualeteve, vendosja e pikturave në mure dhe komodinat personale. **MKPT konsideron se ka mungesë të privatësisë tek tualetet që nuk kanë fare perde dhe kjo çështje duhet të zgjidhet urgjentisht.**
10. Kuzhina u rinovua dhe u lëshua në përdorim në korrik të vitit 2018 dhe është e pajisur me të gjitha pajisjet moderne. Përmes raportit me rekomandime të publikuar më 6 mars 2017, MKPT e Avokatit të Popullit rekomandoi ndërmarrjen e masave për renovimin e kuzhinës. Përmes këtij raporti MKPT e Avokatit të Popullit përshëndet zbatimin e këtij rekomandimi.
11. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës rëndësi të veçantë i kushton edhe ushqimit të pacientëve, ushqimi jo vetëm që duhet të jetë i përshtatshëm nga pikëpamja e sasisë dhe cilësisë, por edhe të jepet në kushte të kënaqshme. Gjatë vizitës, MKPT u njoftua që Qendra është e furnizuar mirë dhe me rregull me ushqim dhe se stafi i kuzhinës posedonin librezat sanitare. MKPT nuk ka hasur në ushqime me afat të skaduar. Në Qendër, ushqimi përgatitet sipas menysë dhe u jepet në tri shujta.

Kujdesi shëndetësor

12. MKPT u njoftua se, në QIRSKP ofrohen shërbime të rregullta psikiatrike, ku këto shërbime i kryen drejtori i Qendrës pasi që me profesion është psikiatër, ndërsa në rast nevojë, shërbimet tjera shëndetësore dhe specialistike u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime, Spitali Rajonal në Ferizaj dhe Qendra Klinike Universitare në Prishtinë.
13. Puna në QIRSKP konsiston në vizitat e mëngjesit, vizitat individuale në ambulancë dhe çdo 3 javë kontroll e përgjithshme psikiatrike. Konsultimet tjera me prioritet kryhen në SHSKUK dhe Qendrën e Mjekësisë Familjare. Të gjitha femrave u është bërë kontrolla gjinekologjike, një herë në tre muaj u bëhen edhe vizita internistike si dhe një herë në muaj kontrolla PPD (test në lëkur për tuberkulozin). Njësia shëndetësore posedon bombolën e oksigjenit, një sterilizator, EKG, defibrilator, antishokun dhe një tensiometër.
14. Përdorimi i medikamenteve antipsikotike, antidepresive dhe anksiolitike nga ekzaminimi i disa dosjeve mjekësore duket se është i arsyeshëm dhe i bazuar në evidenca. Sipas personelit, përdorimi i barërave është reduktuar shumë dhe janë më racional në përshkrimin e tyre. Zakonisht i posedojnë preparatet nga lista esenciale si: haloperidol, moditen, risperidon, olanzapine etj (10 pacientë ishin duke u trajtuar me haloperidol depo kurse 15 me moditen depo). Sipas informatave të marrura, ka raste kur QIRSKP ballafaqohet me mungesë të barërave. **MKPT konsideron se është përgjegjësi e autoriteteve kompetente që të furnizojnë këtë institucion rregullisht me barnat e nevojshme.**
15. Në raste urgjence mjeku thirret në telefon. Ai shpesh detyrohet të ordinojë terapinë pa e vizituar pacientin. MKPT konsideron se ordinimi i një terapie, qoftë edhe urgjente, pa bërë një vizitë mjekësore të përshtatshme mund të jetë objekt i neglizhencës. Prandaj, autoritetet kompetente duhet të sigurojnë numrin adekuat të stafit mjekësorë (psikiatër) si parakusht për një trajtim adekuat.

16. MKPT ka vërejtur se institucioni posedon regjistrat si në vijim: regjistri i rezidentëve që përdorin narkotikë, regjistri i abuzimeve seksuale, lëndimeve trupore, vetëlëndimeve, vetëvrasjeve, vdekjeve, regjistri i lëndimeve të punëtorëve të shkaktuara nga rezidentët, regjistri për analiza laboratorike, për vizita stomatologjike të kryera jashtë Qendrës, regjistri për sterilizim, vaksinim, regjistri për kontrolle psikiatrike dhe të përgjithshme, regjistri për lëndim dhe lidhje plagësh etj.
17. Dosjet janë të ndara në psikiatrike dhe dosje organike. MKPT ka vërejtur se historia e pacientit të shumtën e rasteve është e zbrazët, nuk ka shënime edhe aq të detajuara në shënimet përcjellëse shëndetësore. MKPT inkurajon stafin që në regjistra, të përshkruhet ngjarja përkatëse më hollësisht.
18. Sistemimi i dosjeve sociale nuk ishte në funksion. Në të kaluarën ky institucion e ka poseduar data-bazën, e cila ka funksionuar vetëm 1 vit dhe nga viti 2016 ky sistem është ndërprerë, për shkak se Ministria e Shëndetësisë nuk e ka vazhduar kontratën.
19. Rrjedhimisht, dosjet elektronike nuk ekzistojnë. MKPT konsideron se duhet të aktivizohet ky sistem elektronik i evidentimit, i cili është shumë i domosdoshëm për funksionimin e mirëfilltë të institucionit.

Trajtimi dhe aktivitetet

20. Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur një qasje të afërt dhe miqësore nga ana e stafit ndaj pacientëve, pra kryesisht vërehej një klimë pozitive brenda institucionit. Pacientët duken mirë për nga veshja dhe higjiena. Nuk kemi rastisur në shenja të lëndimeve. Nga intervistat me pacient nuk kishte ndonjë ankesë për ndonjë formë të keqtrajtimit. Po ashtu, MKPT, gjatë intervistave me rezidentë, nuk ka pranuar ankesa për keqtrajtim apo sjellje të personelit të cilat cenojnë dinjitetin e rezidentëve.
21. Aktivitetet psiko-sociale që zakonisht kryhen janë: piktura, muzika, ekskursionet. Institucioni posedon një tavolinë për aktivitete, TV nuk punonte në repartin A2 por në repartet tjera punonte, nuk ka lojëra as libra, pasi që janë dëmtuar. Vizitat e familjarëve janë të lejuara kurdo që duan. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës thekson se, mbajtja e kontakteve me botën e jashtme është thelbësore jo vetëm për parandalimin e keqtrajtimit por edhe nga një pikë vështrim terapeutik¹.
22. MKPT vëren se plani i aktiviteteve nuk është i shkruar, as planet individuale nuk ekzistojnë, ndërsa buxheti për aktivitete psikosociale është i vogël. Vikendet terapeutike janë shumë të rralla për shkak se familjet nuk shprehin interesim.
23. **MKPT shpreh brengosjen për faktin se numri dhe cilësia e aktiviteteve psiko-sociale dhe rekreative është shumë i mangët.** Po ashtu nuk ka një plan të individualizuar të trajtimit me përfshirje të pacientit. MKPT në raportin me rekomandime të vitit 2017 ka rekomanduar fokusimin në planifikimin e ndërtimit të një njësie vokacionale, por kjo nuk është bërë deri më tani. **Institucioni duhet të angazhohet me përparësi në shtimin e aktiviteteve psiko-sociale dhe përfshirjen e të gjithë pacientëve në mënyrë optimale në këto aktivitete.**
24. Sipas Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, trajtimi psikiatrik duhet të bazohet në një qasje të individualizuar, gjë që nënkupton hartimin e një plani trajtimi për çdo pacient, i cili plan duhet të përfshijë aktivitete rehabilituese dhe terapeutike, duke përfshirë psikoterapi individuale, terapi në grup, art, teatër, muzikë dhe sporte. Pacientët duhet të

¹ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 8-të i Përgjithshëm, paragrafi 54.

kenë qasje të rregullt në dhoma argëtimi të pajisura përshtatshëm dhe të kenë mundësi të bëjnë ushtrime ajrimi në qiell të hapur.²

25. Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur se vetëm një pacientë me diagnozë primare me paaftësi në mësim ende qëndron me pacientët e tjerë që zakonisht vuajnë nga çrregullimi psikotik kronik. Nga pikëpamja e MKPT, vendosja e tyre e përbashkët lejon mundësinë e keqtrajtimit të kësaj kategorie. Prandaj, MKPT konsideron se duhet të bëhen aranzhime në mënyrë që të mos vjen deri te akomodimi i përbashkët i këtyre kategorive specifike.
26. Po ashtu, MKPT evidentoi 4 raste të cilave gjykata u ka caktuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në QIRSKP, përkundër faktit se institucioni nuk ka kushte për ti menaxhuar. Sipas MKPT, QIRSKP nuk ka as bazë ligjore dhe as kapacitete për të vazhduar trajtimin e rasteve të tilla. MKPT inkurajon stafin e QIRSKP, që rregullisht t'i njoftojnë gjykatat për gjendjen shëndetësore të këtyre rasteve.
27. Lidhur me çështjen e shqyrtimit efektiv të rasteve të tilla, rasteve të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe trajtimeve të tjera në institucionet e shëndetit mendor, nga gjykatat kompetente dhe institucionet tjera të cilat në një fazë të caktuar mund të përballen me persona me çrregullime mendore, Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë më 18 shtator 2018 kanë mbajtur punëtorinë ku janë ftuar të gjithë akterët relevant si psikiatër, gjyqtar, prokuror me qëllim të diskutimit dhe përmirësimit të gjendjes në këtë aspekt.
28. Gjatë kësaj punëtorie u arrit konkludimi se Ministria e Shëndetësisë duhet të përpilojë listën e institucioneve të shëndetit mendorë ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Trajtimi i rasteve që nuk janë në kapacitetet e një institucioni përbën parakusht për keq-trajtim ose neglizhencë.

Parandalimi i vetëvrasjeve

29. Sipas drejtorisë, kanë ndodhur dy vetëvrasje pas lufte, ndërsa tentim-vetëvrasjet janë të shpeshta. Gjatë vitit 2018, në këtë institucion kanë ndodhur dy raste të vdekjes. QIRSKP nuk ka ndonjë plan parandalues specifik lidhur me vetëvrasjet. **MKPT konsideron se është e nevojshme të hartohet një udhërrëfyes i qartë i cili efektivisht do të ndihmojë në identifikimin e rasteve me tendenca suicidale, hartimin e një skeme observimi të veçantë me mbështetjen imediate psikologjike/psikiatrike.**

Personeli i QIRSKP

30. Personeli i QIRSKP numëron 39 të punësuar, 1 psikiatër i cili është edhe drejtori i institucionit, 9 infermierë, 16 ndihmës mjekësorë, 7 punëtorë administrativë dhe 7 punëtorë të shërbimeve teknike.
31. MKPT konsideron se numri i stafit nuk është adekuat. Po ashtu, mungojnë profesionistët si p.sh psikolog, trapistët okupacional etj. MKPT në raportin me rekomandime të publikuar më 6 mars 2017 ka rekomanduar punësimin e një psikologu klinik dhe një punëtori social shtesë, por kjo nuk ka ndodhur deri më tani. **Autoritetet dhe institucionet duhet të sigurojnë numrin adekuat të stafit mjekësorë (psikiatër, infermierë, terapistë okupacional) si parakusht për një trajtim adekuat.**
32. MKPT u njoftua se puna bëhet në 3 ndërrime gjatë 24 orëve. Dy infermierë punonin ditën, dhe dy natën; ndonjëherë edhe vetëm një infermierë natën në kohën e pushimeve. Stafi

² Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm [CPT/Inf (98) 12]

ndjehet tepër i ngarkuar, i stresuar nga specifikat e punës dhe i pashpërblyer në mënyrë adekuate për natyrën e punës.

33. Sipas personelit të QIRSKP atyre nuk u ofrohen trajnime. MKPT e sheh si shumë të rëndësishme ofrimin e trajnimeve profesionale jashtë institucionit si dhe shpërblimi adekuat bazuar në specifikat e punës. MKPT konsideron se mënyra se si personeli e percepton kualitetin e jetës në punë dhe mënyra se si ata trajtohen nga menaxherët dhe kolegët e tyre ka një ndikim të rëndësishëm në atmosferën në institucion dhe në trajtimin e rezidentëve. Zyrtarët e institucionit të cilët ndjehen të çmuar, të besueshëm dhe të respektuar në vendin e tyre të punës kanë gjasa më të mëdha që këto vlera t'i zbatojnë edhe në trajtimin rezidentëve. Kushtet e favorshme të punës në këtë institucion, po ashtu janë të rëndësishme për të tërhequr dhe mbajtur personelin e duhur profesional.
34. Ndhmësit mjekësorë (nuk janë profesionistë mjekësorë) punojnë në 12 orë, një ditën dhe një natën. Ata kryesisht merreshin me pastrimin e pacientëve, si dhe ndihmonin në rastet kur pacientët bëhen agresivë. Ndhmësit mjekësorë nuk kanë asnjë trajnim specifik për punën me pacientët me çrregullime kronike psikiatrike.
35. **MKPT konsideron se stafi i ndihmësve mjekësorë duhet të trajnohen sa më përshtatshëm lidhur me punën specifike që bëjnë duke u kujdesur për pacientët me çrregullime kronike psikiatrike.**

Mjetet e kufizimit

36. Sa i përket mjeteve të kufizimit, neni 27 i Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendorë, përcakton se kufizimi fizik personave me çrregullime mendore zbatohet në institucionet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër dhe përfshin, sipas protokollit përkatës, elementet e mëposhtme: mbajtja me forcë e personit, përdorimi i detyruar i medikamenteve, imobilizimin, izolimin.
37. Bazuar në pohimet e drejtorisë së QIRSKP dhe dosjeve të rezidentëve, në këtë institucion nuk përdoren mjetet mekanike të kufizimit fizik, por vetëm ato kimike, psiko-terapia, intervenimet farmako-terapeutike, nuk përdoren masat izoluese sepse nuk ka kushte për të zbatuar masë të tillë.
38. Sa i përket pëlqimit për trajtim dhe qëndrim, pëlqimi jepet nga familjari ose kujdestari ligjor i rezidentit në rastet kur me vendim të organit kompetent rezidentit i është hequr zotësia e veprimit.
39. **Në repart nuk është e vendosur karta e të drejtave të pacientëve dhe as fletushka për këtë qëllim, vetëm në ambulantë është e vendosur karta e të drejtave.** MKPT konsideron që informacioni lidhur me të drejtat e pacientëve duhet të jetë i vendosur përshtatshëm, në vende të dukshme, të mbështetet me fletushka si dhe të ju shpjegohet sa më përshtatshëm pacientëve.
40. Vizitat e familjarëve janë të lejuara çdo kohë. Por, sipas drejtorisë, nuk ekziston ndonjë interesim nga familjet e pacientëve që të mbajnë kontaktet, qoftë përmes telefonit ose vizitave. Përkundër angazhimit të stafit nuk ka ndonjë rezultat. Stafi është i vetëdijshëm se kjo sferë është shumë shqetësuese, por ndihen të pafuqishëm për ta ndryshuar. Sipas personelit të QIRSKP, ka edhe raste kur kujdestari ligjor i caktuar me vendim të organit kompetent nuk i përmbush detyrat e tij ndaj rezidentit.
41. MKPT vëren se neni 9 paragrafi 4 i Ligjit për Shëndetin Mendorë, përcakton se masat në rastin e mos përmbushjes së kërkesave, bashkëpunimit dhe përkujdesjes së familjarit/kujdestarit ligjor ndaj të sëmurit me çrregullim serioz mendor rregullohet me akt të veçantë nënligjor të cilin e nxjerrë Ministria e Shëndetësisë. Më tej, neni 16, paragrafi 3 i

Ligjit për Shëndetin Mendorë përcakton se Organet e pushtetit lokal dhe Qendrat për punë sociale, brenda kompetencave të tyre, në bashkëpunim me strukturat shëndetësore, marrin të gjitha masat për të mbështetur personat me çrregullime mendore dhe familjet e tyre.

42. MKPT konsideron se mbajtja e kontaktit me botën e jashtme është esenciale jo vetëm për prandalimin e keq-trajtimit por edhe nga aspekti terapeutik. QIRSKP dhe Institucionet tjera të përkujdesjes sociale (MPMS, Qendrat për Punë Sociale) duhet të shqyrtojnë dhe shfrytëzojnë gjitha mekanizmat dhe mundësitë ligjore për ta përmirësuar këtë çështje, ashtu siç e përcakton neni 16, paragrafi 3 i Ligjit për Shëndetin Mendorë. Ndërsa, Ministria e Shëndetësisë duhet të nxjerrë aktet nënligjore ashtu siç parashihet në nenin 9, paragrafi 4 i Ligjit për Shëndetin Mendorë.
43. Në QIRSKP, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vendosur kutitë e ankesave, të cilat mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. MKPT nuk ka pranuar asnjëherë ankesa nga rezidentët apo familjarët e tyre. MKPT inkurajon stafin që të informoj më shumë familjarët e rezidentëve për mundësin e parashtrimit të ankesave përmes kutisë së ankesave të vendosur në QIRSKP.
44. De institucionalizimi që është edhe si një nga preokupimet dhe detyrat e parashikuar për QIRSKP ka ngecur. Për aq sa personeli është në dijeni, vetëm 3 raste janë kthyer në komunitet.
45. MKPT është e mendimit se Ministria e Shëndetësisë duhet të hartoj një politikë të qartë të deinstitutionalizimit duke ndërtuar shërbime efektive në komunitet. MPMS dhe Qendrat për Punë Sociale duhet të përfshihen në ofrimin e burimeve të nevojshme efektive në mbështetjen e një politike të tillë.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16 paragrafi 4 i Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon:

Ministrisë së Shëndetësisë:

- **MKPT e Avokatit të Popullit ri përsërit rekomandimin për nxjerrjen e akteve nënligjore në pajtim me Ligjin për Shëndetin Mendor.**
- **Ministria e Shëndetësisë të marrë një vendim njoftues që i liston institucionet e shëndetit mendor ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.**


Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK):

- **MKPT ri-përsërit rekomandimin për ndërtimin e njësisë vokacionale në kuadër të QIRSKP-së.**
- **Të sigurohet numri adekuat i personelit mjekësorë, si psikiatër, infermierë, psikolog klinik, terapist okupacional si parakusht për një trajtim adekuat.**
- **Të ofrohen trajnime adekuate për personelin.**
- **Të furnizohet rregullisht QIRSKP me barërat e nevojshme.**
- **Të funksionalizohet sistemi kompjuterik i evidentimit (baza e të dhënave).**

- **Të përpilohet Udhërrëfyesi (Strategjia) për parandalim të vetë-vrasjeve.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin”) dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,



Hilmi Jashari

Avokat i Popullit